

SYLLABUS: Tatimet dhe Strategjia e Biznesit

Të dhëna bazike të lëndës	
Njësia akademike:	FAKULTETI EKONOMIK PRISHTINË
Titulli i lëndës:	Tatimet dhe Strategjia e Biznesit
Niveli:	Bachelor
Statusi lëndës:	Obligative
Viti i studimeve:	Viti i II-te, semestri IV
Numri i orëve në javë:	2+1
Vlera në kredi – ECTS:	5 ECTS
Koha / lokacioni:	E hënë 9. ⁴⁵ - 11. ¹⁵ AV
Mësimdhënësi i lëndës:	Driton Balaj
Detajet kontaktuese:	driton.balaj@uni-pr.edu
Përshkrimi i lëndës	Kjo lëndë studentëve do t'u ofrojë njohuritë themelore për konceptet dhe parimet e sistemit tatimor dhe rëndësinë e tatimeve në vendim marrje personale dhe të biznesit. Studentët pritet që të fitojnë njohuri dhe të jenë në gjendje që të kuptojnë ndikimin e tatimeve në transaksionet e individëve, kompanive dhe ndërmarrjeve të veçanta dhe të jenë në gjendje të identifikojnë, diskutojnë dhe të këshillojnë për çështjet tatimore në një situatë të veçantë, si dhe t'i njohin mundësitë e planifikimit që të minimizojnë detyrimet e mundshme tatimore bazuar në njohuritë e fituara. Tatimet janë një lëmi e gjerë, që konsiderohen si pasqyrë e funksionimit të shtetit, e cila në vete ngërthen shumë segmente, ndër të cilat më me rëndësi janë edhe tatimet e aplikuara në Kosovë.
Qëllimet e lëndës:	Qëllimi kryesor i kësaj lënde është që studentët të jenë në gjendje të analizojnë vendimet kritike nga një prespektivë e tatimeve dhe të mësojnë strategjitë e tatimeve, aplikueshmërinë e tyre, sepse kjo do të jetë e vlefshme pavarësisht nga rruga e karrierës së tyre. Studentët do të fitojnë njohurit me ligjin e taksave, të mësojnë të njohin mundësitë e aplikueshmërisë së taksave, të njohin planifikimin mbi bazën e taksave dhe njëkohësisht të fitojnë përvojë duke përdorur mjetet e planifikimit tatimor dhe të jenë në gjendje në të ardhmen për të përmirësuar menaxhimin dhe organizimin e bizneseve sa i përket kësaj fushe.
Rezultatet e pritura të nxënies:	Me përfundimin e kësaj lënde studentët do të jenë në gjendje: Të shpjegojnë funksionimin dhe fushën sistemit

	tatimor; Të shpjegojnë dhe të llogarisin detyrimet e tatimit mbi të ardhurat personale, Te shpjegojnë dhe të llogarisin tatimin në të ardhurat e korporatave; Të shpjegojnë dhe të llogaritin fitimet e tatueshme që rrjedhin nga kompanitë dhe personat fizik dhe juridikë; Të shpjegojnë dhe të llogaritin efektin e kontributeve dhe sigurimeve për punonjësit, punëdhënësit dhe të vetëpunësuarit; Të shpjegojnë dhe të llogarisin Tatimin mbi Vlerën e shtuar; Të njohin të metat dhe përparësitë e tatimeve të aplikuara në Kosovë;		
Kontributi në ngarkesën e studentit (gjë që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënit të studentit)			
Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithsej
Ligjërata	2	15	30
Ushtrime teorike/laboratorike	1	15	15
Punë praktike			
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultim	1	15	15
Ushtrime në teren			
Kollokfiume,seminare	1	5	5
Detyra të shtëpisë	1	10	10
Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	2	15	30
Përgaditja përfundimtare për provim	1	15	15
Koha e kaluar në vlerësim (teste,kuiz,provim final)			
Projektet,prezentimet ,etj	5	1	5
Totali			125
Metodologjia e mësimdhënies:	- Metoda e ligjërimit është interaktive, duke u mundësuar studentëve që të bëjnë pyetje për problemet aktuale në kuadër të ligjërates së mbajtur. Gjithashtu, studentët kanë mundësi që gjatë përgatitjes së lëndës të kontaktojnë me profesorin dhe të marrin udhëzime me qëllim të arritjes së cilësisë dhe rezultateve të dëshëruara në mësim dhe në sukses të studentëve.		
Metodat e vlerësimit:	Vlerësimi i studentëve konsiston në: - Përcjelljen e punës së studentëve gjatë ligjeratave dhe pjesëmarrjen e tyre aktive në ligjërata, ku pjesëmarrja e rregullt dhe aktive do tu sigurojë 10% të notës përfundimtare;		

	- kontrollin e njohurive të fituara të studentëve në gjysmën e semestrit (java e tetë) përmes kollokviumit, i cili do të përfshijë materien dhe materialin e kaluar shtatë javët e para ku do të ketë pyetje dhe detyra; studentët që janë të suksesshëm do të fitojnë 45% të notës përfundimtare; - provimi përfundimtar, i cili do të përfshijë tërë lëndën e ligjësuar gjatë semestrit dhe do të jetë një kombinim i pyetjeve dhe detyrave për t'u zgjidhur; provimi përfundimtar do të përfshijë 45% të notës përfundimtare për studentët që e kanë dhënë kollokviumin, ndërsa 90% për ata të cilët nuk kanë qenë të suksesshëm.
Literatura	
Literatura bazë:	• Prof.Dr.Driton Balaj “Ligjerata të autorizuara, Prishtine, 2010-2011,
Literatura shtesë:	• Myron S. Scholes, Mark A. Wolfson, Merle Erickson et al. “Taxes and Business Strategy A Planning Approach 5th edition (2015)
Plani i dizajnuar i mësimit:	
Java	
Java e parë:	Hyrje në Strategjinë e Tatimeve
Java e dytë:	Bazat e Planifikimit Tatimor
Java e tretë:	Kthimi nga Investimet Alternative / Mjetet e Kursimit
Java e katërt	Zgjedhja e Formës Optimale të Organizimit të Biznesit
Java e pestë gjashtë:	Tatimet implicite dhe Klientët, Arbitrazhi, Kufizimet dhe Friksionet
Java e gjashtë:	Kostot jo Tatimore të Planifikimit Tatimor
Java e shtatë:	Rëndësia e Normave Tatimore Margjinale dhe Planifikimi dinamik i tatimeve
Java e tetë:	Testi i parë
Java e nëntë:	Pensionet dhe Planifikimi i Pensioneve
Java e dhjetë:	Planifikimi i Tatimeve të korporatave ndërkombëtare
Java e njëmbëdhjetë:	Korporatat: Formimi, Operacionet, Struktura e Kapitalit, dhe Likuidimi
Java e dymbëdhjetë:	Bashkimi (shkrirja) dhe fuzionimi i korporatave
Java e trembëdhjetë:	Tatimi në të ardhurat personale , Tatimi i të ardhurave të korporatave në Kosovë
Java e katërbëdhjetë:	Tatimi mbi vlerën e shtuar në Kosovë

Java e pesëmbëdhjetë:	Testi i dytë
------------------------------	--------------

Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:
- Vijimi i rregullt i ligjëratave dhe ushtrimeve është i obliguar për të gjithë studentët e rregullt. - Të gjithë studentët janë të obliguar që t'i përfillin rregullat e mirësjelljes: mbajtja e qetësisë, çkyçja e telefonave celularë dhe hyrja në sallë me kohë.